

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 14

Metro_Polis shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	4,010,519	11,612,268
Llogari të arkëtueshme	5	7,127,318	6,853,130
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	260,991	-
Total Aktive Afatshkurtra		11,398,828	18,465,398
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	541,059	141,565
Total aktive afatgjata		541,059	141,565
Total Aktive		11,939,887	18,606,963
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	8	2,612,330	2,496,249
Detyrime tatimore	9	683,970	1,597,535
Të tjera detyrime	10	535,415	4,064,697
Total Detyrime afatshkurtra		3,831,715	8,158,481
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	11	3,265,273	3,265,273
Total Detyrime afatgjata		3,265,273	3,265,273
Totali i detyrimeve		7,096,988	11,423,754
Kapitali themeltar			
Kapitali i nënshkruar	12	1,800,000	1,800,000
Rezerva Ligjore	12	179,486	179,486
Fitime/humbje të mbartura	12	(943,399)	(943,399)
Fitimi i ushtrimit		3,806,812	6,147,122
Total kapitali		4,842,899	7,183,209
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		11,939,887	18,606,963

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Metro_Polis Shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	13	24,204,670	16,872,250
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	14	(33,788)	17,985
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	15	(9,583,241)	(4,881,681)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime		(9,583,241)	(4,881,681)
Shpenzime të personelit	16	(9,959,617)	(4,726,558)
1) Paga dhe shpërblime		(9,256,273)	(4,389,191)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(703,344)	(337,367)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	17	(109,782)	(40,004)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		(424)	-
Të ardhura të tjera	18	4,583	4,176
1) Interesa të arketueshme dhe të ardhura të ngjashme		4,583	4,176
Shpenzime financiare		-	-
Fitimi/humbja para tatimit		4,522,401	7,246,168
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(715,589)	(1,099,046)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(715,589)	(1,099,046)
Fitimi/humbja e vitit		3,806,812	6,147,122
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		3,806,812	6,147,122

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Metro_Polis Shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitim/Humbja e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	1,800,000	-	(943,399)	3,589,720	4,446,321
Fitimi / Humbja e vitit				6,147,122	6,147,122
Transferim ne fitime te mbartura	-	179,486	3,410,234	(3,589,720)	-
Dividendë të paguar	-	-	(3,410,234)	-	(3,410,234)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	1,800,000	179,486	(943,399)	6,147,122	7,183,209
Fitimi / Humbja e vitit				3,806,812	3,806,812
Transferim ne fitime te mbartura	-	-	6,147,122	(6,147,122)	-
Dividendë të paguar	-	-	(6,147,122)	-	(6,147,122)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	1,800,000	179,486	(943,399)	3,806,812	4,842,899

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i shoqërisë "Metro_Polis" Shpk më __ Mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.



Z. Besnik Atkaj, Architecture & Planning sh.p.k.
Administrator



Rr. Emin Duraku, Pall "Bijakët",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Mazars shpk
Hartues PF

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	3,806,812	6,147,122
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	33,788	(17,985)
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jomonetar	715,589	489,868
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	109,782	40,004
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(1,250,768)	4,015,833
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(3,866,696)	3,856,913
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(460,070)	(4,826,626)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(911,563)	9,705,129
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(509,276)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(509,276)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	-	(500,000)
Dividente te paguar	(6,147,122)	(3,069,211)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(6,147,122)	(3,569,211)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(7,567,961)	6,135,918
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	11,612,268	5,458,365
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(33,788)	17,985
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 4,010,519	11,612,268

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "METRO_POLIS" sh.p.k. është krijuar sipas Vendimit Nr.38596 datë 18.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është :

Studio projektimesh dhe konsulence masterplane, objekte civile etj. Kapitali themeltar është 1,800,000 lekë.

Selia e shoqërisë është : Autostrada Tiranë-Durrës Km 5 Kashar Tiranë. Administrator është Z. Besnik Aliaj.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet e pasqyrave financiare.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/LEK	125.79	115.23

3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria në fillim regjistron aktivitet dhe detyrimet financiare me vlerën e tyre të drejtë.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Çdo interes në transferimin e aktiveve financiare që është krijuar ose mbajtur nga shoqëria është njohur si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit për efekt fiskal për vitin aktual janë si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iii. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

3.6 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

3.7 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

Metro_Polis Shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Më 31 dhjetor 2015 në Lek	Më 31 dhjetor 2014 në Lek
Mjete monetare në Lek	<u>2,981,979</u>	<u>8,298,682</u>
Arka	30,536	71,816
Banka	2,951,443	8,226,866
Mjete monetare në valutë	<u>1,028,540</u>	<u>3,313,586</u>
Arka	-	-
Banka	1,028,540	3,313,586
Totali	<u><u>4,010,519</u></u>	<u><u>11,612,268</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë të arkëtueshme janë paraqitur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Llogari të pagueshme	<u>7,127,318</u>	<u>6,853,130</u>
Totali	<u><u>7,127,318</u></u>	<u><u>6,853,130</u></u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Tatim Fitim i parapaguar	<u>260,991</u>	-
Totali	<u><u>260,991</u></u>	-

Metro_Polis Shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

7. Aktive Afatgjata Materiale

	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Totali
Kosto			
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	328,831	309,828	638,659
Shtesa		-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	328,831	309,828	638,659
Shtesa	240,010	269,266	509,276
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	568,841	579,094	1,147,935
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	221,079	236,011	457,090
Amortizimi i vitit	21,550	18,454	40,004
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	242,629	254,465	497,094
Amortizimi i vitit	30,982	78,800	109,782
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	30,982	78,800	109,782
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	107,752	73,817	181,569
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	86,202	55,363	141,565
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	295,230	245,829	541,059

Metro_Polis Shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lek)

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Furnitorë	2,612,330	2,496,249
Totali	2,612,330	2,496,249

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Sigurime Shëndetësore & Shoqërore	177,655	86,322
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	122,270	53,315
TVSH	325,704	968,030
Tatim Fitim	-	489,868
Tatim në burim	58,341	-
Totali	683,970	1,597,535

10. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Te tjere debitoare/kreditore	-	3,069,212
Paga të pagueshme	535,415	995,485
Totali	535,415	4,064,697

11. Hua Afatgjata

Zeri huamarrje afatgjata paraqitet ne vleren 3,265,273 leke si me poshte:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Hua Afatgjata	3,265,273	3,265,273
Totali	3,265,273	3,265,273

12. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 1,800,000 leke.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 3,806,812 lekë përfaqeson fitimin e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2015.

13. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Shoqëria gjatë vitit 2015 ka realizuar të ardhura nga aktiviteti i saj kryesor .

	31 dhjetor 2015 në Lek	31 dhjetor 2014 në Lek
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	24,204,670	16,872,250
Totali	24,204,670	16,872,250

14. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015 në Lek	31 dhjetor 2014 në Lek
Humbje nga këmbimet e llogarive tregtare	(33,788)	-
Fitim nga këmbimet e llogarive tregtare	-	17,985
Totali	(33,788)	17,985

Kuadrimi i qarkullimit sipas Formularëve të deklarimit të TVSH-së:

Qarkullim i tatueshëm	24,204,670
Zbriten Humbje nga këmbimet e llogarive tregtare	(33,788)
Qarkullimi i korigjuar	24,170,882
Sipas Pasqyrave Financiare më 31.12.2015	24,170,882
Diferenca	-

Metro_Polis Shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 (Vlerat janë në Lek)

15. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Shpenzime qeraje	167,542	167,801
Blerje të ndryshme, kancelari etj	52,071	253,865
Shërbime nga te trete	8,101,140	1,667,233
Shpenzime të tjera	919,999	2,608,319
Shpenzime transporti	233,050	138,030
Dieta	67,832	-
Komisione bankare	21,487	24,438
Taksa të ndryshme	20,120	21,995
Totali	9,583,241	4,881,681

16. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Pagat e personelit	9,256,273	4,389,191
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	703,344	337,367
Totali	9,959,617	4,726,558

17. Shpenzime amortizimi

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Shpenzime amortizimi	109,782	40,004
Totali	109,782	40,004

18. Te ardhura te tjera

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
	në Lek	në Lek
Interesa te arketueshme dhe të ardhura të ngjashme	4,583	4,176
Totali	4,583	4,176

19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i Tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2014: 15%). Formularët e deklarimit të Tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni Tatimor dhe Ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Më 31 dhjetor 2015 në Lek	Më 31 dhjetor 2014 në Lek
Fitim i vitit para tatimit	4,522,401	7,246,168
Humbje e mbartur	-	-
Shpenzime të pazbritshme	248,198	80,803
Fitimi fiskal para tatimit	4,770,599	7,326,971
Tatimi mbi fitimin	(715,589)	(1,099,046)
Fitimi neto	3,806,812	6,147,122

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	%	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	%
Fitimi i vitit para tatimit	4,522,401	100%	7,246,168	100%
Tatim fitimi me normën e aplikueshme	678,360	15%	1,086,925	15%
<i>Rregullimet për diferencat:</i>				
Shpenzime të pazbritshme	37,230	1%	12,120	0%
Totali	715,589	16%	1,099,046	15%

20. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë Çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

21. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.